

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME MIRDITË

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Mirditë me objekt “Mbi zbatimin e rregullshmërisë në praktikën e mbylljes së kontratës me objekt “Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, faza e II” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.159, datë 14/12/2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 728/6, datë 14/12/2015, dërguar z. Mark Leka, Administrator i Ujësjellës Kanalizime, Mirditë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Nga auditimi i praktikës dokumentare të ndodhur pranë Ujësjellës Kanalizime Mirditë, konstatuam mungesë të theksuar bashkëpunimi dhe mosrespektim të detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes së ujësjellësit (autoriteti kontraktor), mbikqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve. Si pasojë e kësaj marrëdhënie të vështirë dhe të parregulluar mirë administratorja e Ujësjellës Kanalizime, Mirditë ka refuzuar të marrë në dorëzim dosjen përfundimtare të punimeve si dhe të pranojë situacionin përfundimtar të objektit duke krijuar situatë të vështirë si për vënien në shfrytëzim të rrjetit të shpërndarjes së përfunduar (pamundësia për të lidhur kontrata të vlefshme në një rrjet të pa marrë në dorëzim) por duke krijuar edhe risk potencial financiar për financat e shoqërisë. Çdo vonesë në kolaudimin e investimit e bën të pamundur shfrytëzimin e veprës së ndërtuar duke krijuar të ardhur të munguar nga moslidhja e kontratave për furnizim me ujë me banorët e zonës, si dhe i jep mundësi shoqërisë të ngrejë pretendime për çdo kontratë të lidhur në kushtet e mos marrjes së veprës në dorëzim.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nisur nga problematika e kësaj kontrate por duke vlerësuar dhe nivelin e investimeve të domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes, në mënyrë që të parandalohen situata të tilla me efekte negative për financat e ndërmarrjes, nga ana e Këshillit të Mbikëqyrjes, të kërkohen plotësime në formatin e kontratës së mbikqyrjes së punimeve, në referencë të detyrimeve (përcaktim të qartë) kryesisht lidhur me përgjegjësitë që mbikqyrësi duhet të ketë lidhur me cilësinë e zbatimit të punimeve dhe përgjigjes përpara institucioneve kontraktore të çdo pretendimi të ngritur lidhur me kontratat që mbulojnë. Kjo lloj përgjegjësie e forcuar edhe në përcaktimet kontraktore do të sigurojë komunikim korrekt në respekt të mbrojtjes së interesave të shtetit por dhe në respekt të sipërmarrjes së lirë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nisur nga fakti se në bazë të ligjit nr.8402, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe kontratës mes palëve, mbikqyrësi ka përgatitur relacionin që i është dërguar administratorit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime, Mirditë për kolaudim. Nga ana e administratorit, punimet janë refuzuar kryesisht mbi bazë të pretendimeve mbi cilësinë e punimeve, si lidhur me pusetat e shkarkimit, apo pretendimit që tubat janë të futur cekët në tokë,

apo mungesës së ajruesit. Nga ana tjetër janë ngritur pretendime për depot e Rrushkullit, Prosekut, e Perlatit, apo nivelit të ujit që vjen në tubacion.

Për shkak të mungesës të personelit inxhinierik në ndërmarrje këto pretendime nuk janë faktuar dhe për to nuk është përgatitur një raport ekspertize mbi të cilin të gjykohej për vërtetësinë e pretendimeve, nga ana tjetër nga verifikimi i dosjeve në ndërmarrje konstatuam se pretendimet kanë lidhje me projektin dhe jo me zbatimin e punimeve fakt që ngre një problem madhor lidhur me projektimin e rrjetit të shpërndarjes në ujësjellësa. Nga ana e administratorit nuk janë ngritur pretendime ligjore apo nuk ka procedim lidhur me to.

Për sa më sipër rekomandojmë

- Të ketë një vlerësim të drejtë të kriterëve dhe kushteve në të cilat duhet të realizohet rrjeti i shpërndarjes, kjo do të eliminojë praktikën e projekteve të cilat nuk marrin parasysh kushtet e zonën ku shtrohen dhe aspekte të tjera teknike në funksion të mirë të rrjetit.

- Nga administratori i shoqërisë të merren masa për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e kontratave me sipërmarrësit, me mbikëqyrësit e me kolaudatorët për të gjitha punimet e shërbimet që do kryhen në të ardhmen, në mënyrë që edhe problematikat e ndryshme të projektimit apo ndryshimeve të detyrueshme të ndodhin në kohë dhe në mirëkuptim të palëve kjo për të siguruar investime me cilësi dhe efektivitet, në funksion të një shërbimi sa më të mirë të furnizimit me ujë.

- Këshilli Mbikëqyrës të evidentojë hapat konkret dhe marrjen e masave për abuzimet e konstatuara mbi indiciet për shpërdorimin e detyrës shtetërore në këtë auditim duke adresuar përgjegjësitë administrative dhe ligjore në organin e akuzës.

- Këshilli Mbikëqyrës të analizojë e të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për abuzimet e konstatuara dhe të ketë një monitorim të vazhdueshëm për të parandaluar konstatime të tilla në të ardhmen, duke adresuar në çdo rast përgjegjësitë administrative dhe ligjore deri në kallëzim penal të abuzimit me detyrat shtetërore.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. Nga auditimi u konstatua risk i lartë operacional për shkak të mungesës së kapaciteteve të nevojshme dhe brenda kërkesave rregullative. Kështu rezultoi se nuk është zbatuar Ligji Nr.8102 datë 28.03.1996 “*Struktura rregullatore e sektorit të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura*”, i ndryshuar si dhe nuk janë zbatuar rregulloret dhe normativat e nxjerra nga Enti Rregullator i Ujit, lidhur me inxhinierin që duhet të ketë në strukturën e saj. Shoqëria ka lidhur kontratë punësimi me kohë të pjesshme për pozicionin e inxhinierit ndërkohë kur kushtet e Liçensimit mbi grumbullimin, shpërndarjen, përpunimin e ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura, pika 32, pika 33., kërkojnë një Ing. Ndërtimi ose Ing.Hidroteknik me kohë të plotë me liçensat përkatëse.

Personi i kontraktuar nuk ishte i deklaruar në listëpagesat e sigurimeve shoqërore, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 119, "Mosdeklarimi i punonjësve".

Nga auditimi rezultoi se ish-administratoresha e shoqërisë nuk ka zbatuar vendimet e Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me strukturën e shoqërisë, nuk ka marrë masa për krijimin e strukturave

teknike që nevojiten për funksionimin ndërmarrjes, nuk ka zbatuar legjislacionin tatimor, nuk ka zbatuar detyrimet kontraktore që ka shoqëria me të tretët.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 163, *Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia*.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga Këshilli Mbikqyrës të merret në analizë struktura dhe përbërja e personelit të Ujësjetllës Kanalizime në Mirditë, të vlerësohet drejtësisht risku operacional i verifikuar në këtë mision të pjesshëm auditimi dhe të merren masa të menjëhershme për të plotësuar strukturat duke përcaktuar edhe kritere të mirëparacaktuara për punonjësit sipas funksioneve që do të realizojnë, kjo si masë për të garantuar një aktivitet dhe performancë të kënaqshme.

Të eliminohen praktikatat e punësimit në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me efekte si për skemën e sigurimeve shoqërore edhe për individin.

Menjëherë

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për znj....., ish-administratore e shoqërisë për të cilën nuk rekomandojmë masë disiplinore duke e konsideruar të ezauruar, për arsye se marëdhëniet e saj të punës me Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Mirditë janë ndërprerë. Masa e propozuar do të ishte:

“Zgjidhje të kontratës së punësimit” për: znj.....

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Blerin Shkurti, Aldo Kume, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.